

**Çështja:** Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve kundër gazetave Shekulli, Panorama dhe portalit Balkanweb

**Ankesa:**

*(Në lidhje me vajzën 13 vjeçare të përdhunuar në Sarandë)* Ne kemi indentifikuar keto gazeta " Shekulli", "Panorama", "Ballkan Web", "Lajmi.Net te cilat kane raportuar lajmin ne shkelje te te drejtave te femijes me argumentat si me poshte: Edhe pse identeti i vajzës nuk është publikuar, identifikimi i saj bëhet i mundur në mënyrë të tërthortë pasi:

1. gjatë raportimit të lajmit është publikuar emri dhe mbiemri i nënës, se femijes viktime e
2. abuzimit seksual
3. është intervistuar nëna dhe babai i vajzës me zë dhe figurë
4. është publikuar njësia administrative dhe emri i fshatit, ku ka ndodhur ngjarja
5. janë publikuar pamje të lagjes ku banon vajza e abuzuar

Mënyra e raportimit me detaje, që e bëjnë fëmijën të identifikueshme lehtësisht në komunitetin e saj, përben barrierë në vazhdimësinë sa më normale të jetës së vajzës. Identifikimi në media i fëmijëve viktime të abuzimit seksual duhet evituar sa më shumë të jetë e mundur, pasi nuk është në interesin më të lartë të fëmijes, dhe nuk ka asnjë interes publik që justifikon intervistimin dhe publikimin e detajeve të jetes së fëmijës dhe të abuzimit.

Mënyra e raportimit të lajmit duke publikuar detaje tw abuzimit është në shkelje të drejtpërdrejtë të dinjitetit dhe të të drejtave të fëmijës.

Raportimi fokusohet në detajet e ngjarjes, duke anashkaluar problematikën e abuzimit të fëmijës. Nuk ka asnjë informacion lidhur me të drejtat e fëmijës që shkelen dhe me mbrojtjen e veçantë që gëzojnë fëmijet, duke përfshirë edhe mbrojtjen nga abuzimi

seksual.

Mënyra e raportimit me detaje, që e bëjnë fëmijën të identifikueshme lehtësisht në komunitetin e saj, përben barrierë në vazhdimësinë sa më normale të jetës së vajzës. Intervistimi i fëmijëve viktime të abuzimit seksual duhet evituar sa më shumë të jetë e mundur, pasi nuk është në interesin më të lartë të fëmijes, dhe nuk ka asnjë interes publik që justifikon intervistimin dhe publikimin e detajeve të jetës së fëmijës dhe të abuzimit.

### **Linket:**

[\(Shekulli Online\) \*Përdhunimi në Sarandë/ Detaje të reja, prindërit: E kishte droguar vajzën me kanabis dhe ajo s'mbante mend asgjë \(Video\)\*](#)

[\(Balkanweb\) \*Nëna e 13-vjeçares që u abuzua në Sarandë: Ia besova vajzën, më tha që s'do ta prekte me dorë \(VIDEO\)\*](#)

[\(Panorama online\) \*Përdhunimi i të miturës në Sarandë, flet nëna: Më tha që s'do ta prekte me dorë, unë...\*](#)

### **Vendimi i Bordit të Etikës**

Bordi i mbledhur në datën 08-Nëntor-2017, shqyrtoi rasti në fjalë, në lidhje me ngjarjen e vajzës 13 vjeçare nga Saranda.

Pas shqyrtimit të rastit, mbështetur në Kodin e Etikës (2006) bordi arriti në përfundimin se:

- 1. Nuk mund të konkludojmë që ka shkelje** për rastin e publikimit me video e zë të nënës dhe babait sepse ata janë madhorë, dhe nga materiali i paraqitur nuk vërtetohet dot që xhirimi është bërë pa dashjen e tyre. E njëjta vlen dhe për transmetimin e emrit e të mbiemrit.
- 2. Nuk mund të konkludojmë që ka shkelje** në rastin e identifikimit të vendit

ku ka ndodhur ngjarja (përfshirë dhe të dhënat e njësisë administrative) pasi është pjesë e punës së gazetarisë, përndryshe nuk përbën lajm.

3. **Ka shkelje të etikës** në rastin kur vajzës i përmendet mbiemri (T.Qafa.)
4. **Ka shkelje të etikës** kur identifikohet si fajtor autori i prezumuar, duke u shkelur prezumimi i pafajësisë derisa të ketë vendim të prerë nga gjykata.

Bordi, rekomandon:

1. Duke qenë se burimi kryesor i lajmit duket se vjen nga TV-të (NEWS 24 dhe REPORT TV) t'i bëhet rekomandim AMA-s të marrë masa në lidhje me 2 shkeljet e vërejtura.

Dt .09/11/2017

Bordi I Etikes

Agim Baci

Denada Toce

Enio Haxhimihali

Dorian Mantlija

Mark Marku